



Datë: 08.05.2025
Numër Protokolli: 3136/2025

A.nr.497/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.497/2025, të datës 18.03.2025, të parashtruar nga ankuesi S.S, kundër organit të punësimit: Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ***shpallet jo kompetent*** për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.497/2025, të datës 18.03.2024, të parashtruar nga ankuesi S.S.

II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi, S.S. (*tutje referuar vetëm: Ankuesi*), më datë 18.03.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.497/2025, kundër zhvillimit të procedurës së rekrutimit me Numër reference RN00016316, për pozitën e punës *Drejtor i Departamentit të Bibliotekës dhe Arkivit* në Akademinë e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.497/2025, të datës 18.03.2025, të parashtruar nga ankuesi, **sepse**:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, më datë 14.01.2025, ka shpallur konkursin me numër reference RN00016316, për pozitën *Drejtor i Departamentit të Bibliotekës dhe Arkivit*, me afat aplikimi nga data 15.01.2025 deri më 13.02.2025. Tutje, bazuar në Njoftimin me numër protokoli 240 të datës 28.02.2025, për përzgjedhjen e kandidatit fitues për pozitën e punës *Drejtor i Departamentit të Bibliotekës dhe Arkivit*, kandidatja R.I me gjithsejtë 98.2 pikë të arritura është shpallur kandidate fituese, ndërsa ankuesi me 75.2 pikë të arritura është renditur i treti.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se përbërja e Komisioni të Pranimi është në kundërshtim me nenin 22 paragrafin 2.1 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023, një kandidate pa poseduar përvojën e punës ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, vlerësimi ka qenë subjektiv dhe jo meritore, duke kërkuar kështu anulimin e konkursit përkatës.

Kolegji i Këshillit në kuptim të pranueshmërisë së ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 5 paragrafi 3 ku përcaktohet se: **3. Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës.**, dhe si rrjedhojë konstatoi se të punësuarit në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, e cila sipas Ligjit Nr.05/L-038 për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, ka statut të pavarur në fushën e shkencës dhe artit, që përfshin promovimin, kultivimin, nxitjen dhe zhvillimin e mendimit shkencor dhe të krijimtariisë artistike, andaj edhe nëpunësit e këtij institucioni dhe kandidatët për pranim në ASHAK, nuk e kanë statusin e Nëpunësit të Shërbimit Civil apo Kandidatit për pranim në Shërbimin Civil, dhe si rrjedhojë të njëjtit e gëzojnë statusin e **Nëpunësit të shërbimit publik** apo kandidatit për pranim në shërbimin publik, sikurse përcaktohet me nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Andaj, meqenëse ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil apo nuk është kandidatë për pranim në shërbimin civil, Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që të shpallë

veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.497/2025 të datës 18.03.2025, të parashtruar nga ankuesi S.S

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi nuk ka parashtruar ankesë brenda organit të punësimit, gjegjësisht i njëjti nuk i ka konsumuar mjetet juridike – administrative, Kolegji i Këshillit, vendosi ashtu që lënda të bartet tek Komisionit për Ankesa të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës në kuptim të dispozitave të nenit 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.497/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, S.S.;
- Udhëheqëses së Personelit në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës;
- Komisionit për Ankesa të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.